

7037

REPUBLIKA E SHQIPERISE

GJYKATA E RRETHIT TIRANE

nr.....7037..... Akti



V E N D I M

PER REGJISTRIMIN TE PERSONIT JURIDIK

Ne Tirane , sot me date 11. 10. 1994, une gjyqtare e votme *Mojza* mbasi u njoha me kerkesen dhe materialat e tjera te paraqitura nga kerkesit Spiro Lluci dhe Vasil Jastru, ne objekt regjistrimin e firmes "S. "S. SARANDA", ne formen e shoqerise ne pergjegjesi te kufizuar

K O N S T A T O V A :

Kerkuesit kane paraqitur prane kesaj Gjykate kerkesen dhe dokumentacionin perkates per te regjistruar firmen "S. SARANDA" ne formen e shoqerise ne pergjegjesi te kufizuar -SH. P. A.

Shoqeria "S. SARANDA" SH.P.K. , do te ushtroje veprimtarine esaj ne keto drejtime :

1. Perpunimin dhe konservimin e peshkut dhe te midhjes;
2. Magazininim dhe shperndarjen e prodhimeve te detit , te perpunuara ose te fresketa , per vete e per te trete.
3. Eksportimin , importimin e lendeve te para, transportimin, tregetin blerjen , shitjen dhe ruajtjen , makinerive , pajisjeve teknike , te produkteve te gatshme , lendeve ndihmese qe kane lidhje me objektin kryesor te shoqerise.
- 4 . Kryerjen e investimeve ne lidhje me objektin e shoqerise.
5. çdo operacion financiar, bankar qe ka lidhje ose jo me objektin e shoqerise dhe qe gjykohet i favorshem per rritjen dhe zhvillimin e shoqerise.



Shoqeri eshte themeluar nga dy palet me perfagesues Spiro Lluci nga pala shqiptare dhe Vasil Jastru nga pala e huaj.

Kapitali themeltar i shoqerise do te jete 17 773000 leke, Pala shqiptare dote kontribojne ne natyre , ne ndertesa, makineri ne vleren e mallit me nje shume prej 5: 550 000 leke ose 259700 dollare.

Qendron e titi kryesore e shoqerise eshte ne çuke, Sarande ne Republikën e

Shqiperise. Afati i veprimtarise se kesaj shoqerie do te jete mbi 10vj.
Kerkesa ehte e bazuar dhe si etille duhet pranuar.

P e r k e t o a r e y e

ne baze te ligjit nr. 7638 date 19.11.1992 dhe ligjit nr. 7667 date 13
01.1993 .

V E N D O S A :

T e regjistroi si person juridik shoqerine "S. SARANDA" - SH.P.K.
per te ushtruar veprimtarine e saj ne fushat: 1. Perpunimi dhe konser
vinin e peahkut dhe te midhjes ; 2. Magazininin dhe shperndarjen e pro
dhimeve te detit , te perpunuara one te fresketa. por vete e per te
trete; 3. Eksportimin , importimin , blerjen , shitjen , ruajtjen , tre
gtimin dhe transportimin e lendove te para , makinerive, pjesëve te kemb
nit , produkteve te gatshme , lendave ndihmese qe kane lidhje ne obje
tin kryesor te shoqerise ; 4. Kryerjen e investimeve ne lidhje ne objek
e shoqerise. 5. çdo operacion financiar , bankar qe ka lidhje ose jo
ne objektin dhe qe gjykohet i favoreshem per rritjen dhe zhvillimin e
shoqerise. SHOQERIA " S. SARANDA " - SH. P. K. eshte me kapital te
perbashket. kapitali themeltar eshte 17773000 leke , ku pjesa e kapi
lit shqiptar eshte 30% dhe pjesa e kapitalit te huaj eshte 70% .
Afati i veprimtarise do te jete mbi 10 vjet.
Kunder ketij vendimi mund te behet ankim ne shkalle te dyte.

TIRANE ME 11.10.1994



[Handwritten signature]

K O N T R A T E



PER KRIJIMIN

E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

(SH.P.K.)

Ndërmjet :

1.Ndërmarrjes së Konservimit të Peshkut dhe Midejes,
Sarandë, person juridik shtetëror shqiptar me qendër në Çukë,
Sarandë, përfaqësuar nga Drejtori i saj Spiro Lluci, i autorizuar
nga Këshilli drejtues,

dhe

2.Vasil Jastru, person fizik me nënshtetësi amerikane, me
banim në 5955 Delafield AVE, Riverdale ,New York.Nr. pasaportës
110578869,

bien dakord të krijojnë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
bazuar në Legjislacionin Shqiptar mbi "Shoqëritë Tregtare",
nr.7638 datë 19 Nëntor 1992.

QELIMI

Henë 1

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar emërtohet _____

S. SARANDA SH.P.K. (e specifikuar përmbri si Shoqëri
me Përgjegjësi të Kufizuar).Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar
është person juridik që vepron sipas Ligjit Shqiptar, me qendër
e tij kryesore në Çukë, Sarandë në Republikën e Shqipërisë.

OBJEKTI

Neni 2

Shoqëria ka për objekt :

1. Përpunimin dhe konservimin e peshkut dhe të mishit ;
2. Magazininin dhe shpërndarjen e prodhimeve të detit, të përpunuara ose të freskëta, për vete e për të tretë,
3. eksportimin, importimin, blerjen, shitjen, ruajtjen, tregtimin dhe transportimin e lëndëve të para, makinerive, pjesëve të këmbimit, produkteve të gatshme, lëndëve ndihmëse që kanë lidhje me objektin kryesor të shoqërisë;
4. kryerjen e investimeve në lidhje me objektin e shoqërisë
5. çdo operacion financiar, bankar që ka lidhje ose jo me objektin e shoqërisë dhe që gjykohet i favorshëm për rritjen dhe zhvillimin e shoqërisë.

Neni 3

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar do të ketë të drejtën sipas Ligjit të Shoqërive, në emër të saj, të përfitojë të drejta pasurore dhe të drejta personale jo pasurore, të marrë përsipër detyrime, të veprojë si paditur ose si i paditur në Gjykatë, në procedurat e Arbitrazhit ose një Gjykatë Arbitrahe.

Neni 4

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar do të fitojë të drejtat e një personi juridik me efekt nga koha e regjistrimit në regjistrin tregtar sipas Nenit 6 të Ligjit mbi Shoqëritë.

Personat që veprojnë në emër të Shoqërisë para së cilës ka fituar personalitet juridik, mbajnë përgjegjësi kolektive për

veprimet e kryera për sa kohë Shoqëria është e rregjistruar në rregjistrin tregtar.

Neni 5

Shoqëria do të udhëhiqet në veprimtarinë e saj nga Legjislacioni Shqiptar dhe gjithashtu nga Kontrata dhe Statuti bashkëlidhur.

Neni 6

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar mund të vendosë degë dhe përfaqësues në territoret e vendeve të Palëve dhe gjithashtu në territore të vendeve të treta. Degët dhe përfaqësuesit do të veprojnë mbi bazën e Rregulloreve të veçanta të miratuara në përputhje me procedurat e vendosura në Statut dhe në ligjin e vendeve ku ato janë vendosur dhe në Ligjin e Shoqërive.

KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË
ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

Neni 7

Kapitali Themeltar do të vendoset në Shoqëri nëpërmjet kontributave të Palëve.

Vlera e Kapitalit Themeltar do të jetë 17 775.000 lekë i barabartë me 1.132.430 dollarë amerikanë në kursin zyrtar 104 të ndarë si vijon :

Palë Shqiptare do të kontribuojë në natyrë, me ndërtesa, makineri dhe vlerën e mallit me një shumë prej 35.332.000 lekë ose 339730 dollarë.

Pala e Huaj do të sigurojë një shumë të barabartë prej 80.441.000 lekë e barabartë me 792.700 dollarë, shumë e cila do të përdoret për blerjen e makinerive e pajisjeve sipas studimit bashkëlidhur dhe marrëveshjes së palëve.

Pjesa e Palës Shqiptare në Kapitalin Themeltar 30 %.

Pjesa e Palës së Huaj në Kapitalin Themeltar 70 %.

Përqindja mund të ndryshojë sipë ushtë përcaktuar në Statut nëse përqindja e Kapitalit Themeltar të kontribuar nga Palët ose nga vetëm njëra prej tyre ndryshon. Kapitali Themeltar mund të riplotësohet nga të ardhurat e aktivitetit ekonomik të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar dhe nga kontributet shtesë të Palëve.

Neni 8

Këshilli Administrativ do të lëshojë dokumentat përkatës (qortifikata, dëshmi ose dëftesa) për vlerat e gjithë kontributeve të realizuara.

Neni 9

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar do të ketë të drejtën e kontrollit të plotë mbi Kapitalin e saj Themeltar, mbasi ai të jetë kontribuar nga Palët. Palët në Shoqëri nuk do të kenë të drejta të veçanta për objekte individuale që formojnë pjesë të pronës së Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar edhe sikur të jenë blerë nga Pala si kontribut.

Çdo Palë do të jetë përgjegjëse vetëm për pjesën e miratuar të kontributit të saj në Kapitalin Themeltar.

Neni 10

Sipas Legjislacionit Shqiptar në veçanti të ligjit nr.7584 i datës 4 Gusht 1992 i cili në çdo rast do të shtohet

në këtë Kontratë, veprimtarinë e Shoqërisë dhe investimet e Palës së Huaj janë të mbrojtura me ligj, dhe Palët do të kenë në çdo moment të drejtën për të transferuar pjesën e vet të fitimit jashtë Shqipërisë në valutën e zgjedhur pasi të ketë paguar takset eventuale.

Neni 10

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar mund të marrë hua në lek ose në valutë të Huaj. Kushtet specifike të marrjes së huasë, zgjedhja e bankave që duan të agjerojnë kreditë dhe sigurimi i garancisë për huanë e marrë do të jenë të drejta brenda drejtimit të Këshillit Administrativ në përputhje me Statutin.

Neni 11

Në mënyrë që të sigurohet vetë mjaftueshmëria e valutës së huaj, Palët kanë për qëllim të shesin produktet në tregun e huaj. Të ardhurat e siguruara në valutë të huaj do të përdoren fillimisht për të mbuluar çdo shpensim të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar Në eksportimin e produkteve Pala e Huaj do të vendosë rrjetin e saj, nëse ka, në dispozicion të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar.

Neni 12

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar cakton nga fitimet e saj një fond legal reserve me një vlerë prej 10 % e Kapitalit Themeltar. Caktimi i fondit legal rezervë bëhet në masën 5 për qind të fitimeve.

Përveq fondit rezervë, Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar mund të formojë fonde të tjera, shumat e të cilave qëllimet për të cilat do të përdoren, tarifet e caktuara dhe procedurat e përdorimit përcaktohen nga Këshilli Administrativ.

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

Neni 14

Palëve u njihon të drejtat e mëposhtme :

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar do të administrohet në përputhje me Kontratën dhe Statutin,

Secila Palë mund të tërhiqet nga Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar nëse është në përputhje me nenin 9 të Statutit.

Neni 15

Palë Shqiptare do të asistojë në të gjitha veprimtaritë e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar nëpërmjet :

1. T'i sigurojë Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar hyrjen në përdorimin e infrastrukturës të furnizimit me gaz, ujë e energji elektrike me çmim kontrate,

2. Të zbatojë procedurat Doganore lidhur me veprimet e eksportit importit.

Neni 16

Palë e Huaj do të asistojë të gjitha veprimtaritë e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar nëpërmjet :

1. Organizimit të eksportit të produkteve të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar nëpërmjet rrjetit të saj të shitjeve, nëse ka;

2. të bëjë hulumtime e kërkime dhe t'i kalojë Këshillit Administrativ informacion mbi mundësitë e shfrytëzimit të rezultateve të këtyre kërkimeve në prodhim;

3. furnizimi i lëndëve të para të importuara, lëndë ndihmëse dhe gjysëm produkte të prodhuara nga Palë e Huaj ose nga firma të tjera të huaja.

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

Neni 17

Organizimi dhe administrimi i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar do të vendoset dhe do të ketë autoritetin dhe detyrat e vendosura në Statut.

Struktura e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar do të jetë :

Asamblea e Ortakëve

Këshilli Administrativ

Drejtori i Përgjithshëm dhe Presidenti

Komisioni i Revizionit dhe i Llogarive

Me Vendim të Këshillit Administrativ organe të tjera mund të emërohen në Shoqëri.

*Administrator. Vazh
Tetra.*

Neni 18

Kontrata është e vlefshme për një periudhë 30 vjeçare me të drejtën e rinovimit siç është shpallur në Statut.

Neni 19

Problemet e punës, pagave, parimeve lidhur me shfrytëzimin e orëve të punës dhe pushimin, stimujt materialë dhe sigurimin e punës dhe të shëndetit rregullohen me kontrata pune. Për probleme që nuk janë parashikuar në kontratat e punës, do të zbatohet Kodi i Punës (sipas Legjislacionit Shqiptar).

Neni 20

Falët do të përjashtohen nga efektet e një moszbatimi parcial ose total i detyrimeve të tyre sipas Kontratës, nëse kjo mospërputhje është si rezultat i rrethanave të një force mëdhe të ndodhur pas përfundimit të Kontratës si rezultat i ngjarjeve

të jashtëzakonisht të cilat Palët e mund t'i parashikojnë ose t'i menjanojnë me mjete për të cilat përgjigjen. Në shprehjen "rrethana të forcës madhore" kuptohen ngjarjet që janë përtej kontrollit të Palëve dhe për ndodhjen e të cilave nuk janë përgjegjëse, për shembull tërmetet, përmbytjet, zjarri.

Neni 21

Paleta për rrethanat mbrojtëse nga forca madhore ka për detyrë të njoftojë me shkrim Palën tjetër për shfaqjen e rrethanave të tilla. Njoftimi duhet të përmbajë hollësi mbi rrethanat po të jetë e mundur një hyrje për efektet e tyre në lidhje me Palën, me detyrimet e saj sipas kontratës, dhe një vlerësim të datës kur Paleta do të jetë përsëri në gjendje t'i përgjigjet detyrimeve të saj.

Neni 22

Për një periudhë pesëvjeçare mbas mbarimit të afatit të kësaj Kontrate dhe pavarësisht nga arsyet e mbarimit, informacioni që ka të bëjë me aktivitetin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar nuk u duhet komunikuar të tretëve, publikuar ose shpallur, veçse pas një leje me shkrim të Palës tjetër. Qëllimi i mosshpalljes së informacionit do të përcaktohet nga Këshilli Administrativ.

Neni 23

Palët duhet të përpiqen të zgjidhin gjithë diskutimet që lindin lidhur me Kontratën. Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin lidhur me Kontratën do t'i nënshtrohen një arbitrimi lidhur me Statutin.

Neni 24

Çdo shtesë ose ndryshim do të marrë formën e një aneksi me shkrim të kësaj Kontrate dhe do të përmbajë pjesë integrale të saj.

Neni 25

Kjo kontratë është përgatitur dhe zbatuar në gjuhët shqip dhe anglisht. Çdo version nënkupton të qënurit në përputhje në të gjitha drejtimet me tjetrin. Në rast se ka ndonjë konflikt ose mospërputhje lidhur me kuptimin ose interpretimin e kësaj Kontratë duhet kontrolluar varianti në shqip.

Çështjet e pambuluara nga kjo kontratë do të rregullohen sipas Legjislacionit Shqiptar.

Sarandë, 7.07. 1993

PËR PALËN SHQIPTARE

PËR PALËN E HUAJ

SPIRO LUÇI

VASIL JATRU



Handwritten signature of Vasil Jatra